

KONTRATË
PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË KONÇESIONIT

“PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE
PASAPORTAVE ELEKTRONIKE”

LIDHUR MË 21 KORRIK 2008

NDËRMJET

MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE GRUPIMIT TË SHOQËRIVE
SAGEM SËCURITË DHE FONDI SHQIPTARO - AMERIKAN I NDËRMARRJEVE

NËNSHKRUAR NË TIRANË MË 13 KORRIK 2010

Lënda

1. Ndryshim i Kontratës së Konçesionit
2. Shtojca

Programe të reja të Kontratës së Konçesionit

- Programi 17 - Specifikimet Teknike për Rritjen e Kapacitetit të Pasaportave
- Programi 18 - Specifikimet Teknike për Dokumentet e Identitetit për Refugjatët
- Programi 19 - Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada
- Programi 20 - Specifikimet Teknike për Shërbimet e Dokumentit me Procedurë të Shpejtë
- Programi 21 - Çështje të Reja Financiare

KJO KONTRATË (në vijim referuar si "Kontrata") lidhet më 13 korrik 2010, në Tiranë, Shqipëri

NDËRMJET:

Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si "Autoriteti") e përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm Z. Lulzim Basha.

dhe

Grupimit të shoqërive Morpho (më parë njohur me emrin Sagem Sécurité, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit sipas ekstraktit historik datë 25.06.2010) dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve rregullisht të përfaqësuar në këtë Kontratë nga ALEAT Shpk (në vijim referuar si "ALEAT" ose "Shoqëria Konçesionere"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjit shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 18.08.2008, me numër unik identifikimi NIPT K82018015V, me seli në adresën Rr. Qemal Stafa, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar në këtë Kontratë nga Z. Jean-Alain Jouan, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Konçesionere.

DUKE PASUR PARASYSH SE:

- A. Autoriteti ka lidhur me grupimin e shoqërive Sagem Sécurité (aktualisht me emrin Morpho) dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve më datë 21 Korrik 2008 marrëveshjen e konçesionit "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike (në vijim referuar si "Konçisioni" ose "Marrëveshja e Konçisionit") për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, siç është ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008;
- B. Autoriteti njuh dhe pranon se në datën e kësaj Kontrate, Konçisionari dhe ALEAT kanë përmbushur në kohë dhe mënyrën e duhur, detyrimet në përgjegjësinë e tyre, sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Konçisionit;
- C. Gjatë zbatimit të Konçisionit, duke konsideruar nevojat e ofrimit të shërbimeve shtesë sipas Nenit 15 të Marrëveshjes së Konçisionit, Autoriteti i ka kërkuar Shoqërisë Konçesionere të ofrojë shërbime dhe/ose pajisje shtesë që nuk parashikoheshin nga Marrëveshja e Konçisionit (këto shërbime shtesë janë ofruar tashmë nga Konçisionari dhe në këtë Kontratë do t'iu bëhet referim si "Shërbimet e Ofruara");
- D. Shoqëria Konçesionere ka realizuar me sukses Shërbimet e Ofruara dhe ka përballuar kostot dhe shpenzimet përkatëse shtesë, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe Programit 21 - Çështje të Reja Financiare (Seksioni 6 - Kostot Shtesë për Shërbimet e Ofruara);
- E. Në bazë të letrës nr. prot. 2632, datë 20.04.2010, Autoriteti i ka kërkuar Shoqërisë Konçesionere të ofrojë shërbime të tjera shtesë, në kuadër të Marrëveshjes së Konçisionit dhe në përputhje me Nenin 15 dhe 25 të saj, të ndryshme nga Shërbimet e Ofruara dhe që përbëhen nga:

1. Dyfishimi i kapacitetit të personalizimit të Pasaportave në 6000 njësi në ditë;
2. Prodhimin dhe pajisjen me Dokumente Identiteti të refugjatëve;
3. Hapja e Zyrave të reja të Aplikimit pranë zyrave konsullore/ambasadave në Greqi (dy zyra) dhe Itali (dy zyra);
4. Parashikimi i procedurave dhe zgjidhjeve për lëshimin e Dokumentit të Identitetit për shtetasit të raste urgjente;

(shërbimeve të listuara më sipër do t'iu bëhet referim në vijim si "Shërbimet Shtesë").

F. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Konçesionit dhe mbështetur në ligjin nr. 10068 datë 02.02.2009 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", të ndryshuar" dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 17, datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar, shitja e kartave të identitetit u bë një furnizim i përjashtuar nga TVSH, dhe si rrjedhojë mbështetur në nenin 25.8 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar, ALEAT nuk i është kredituar plotësisht TVSH e paguar në blerje (blerje brenda dhe jashtë Shqipërisë nëpërmjet mekanizimit të autofaturimit reverse charge). Sipas Nenit 25.2 të Marrëveshjes së Konçesionit, ndryshimi i legjislacionit tatimor si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10068 datë 02.02.2009 ka ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të Konçesionarit sipas Marrëveshjes së Konçesionit, siç specifikohet në Programin 21 (Çështje të Reja Financiare - Seksioni 5);

Në përputhje me sa më lart, Palët bien dakord të ndryshojnë Marrëveshjen e Konçesionit si vijon:

Neni 1 - Ndryshimi i Marrëveshjes së Konçesionit

1.1 Në Programin 1 (Përkufizime) të Marrëveshjes së Konçesionit shtohen termat dhe përkufizimet e mëposhtme:

Shërbime Shtesë - nënkupton:

1. rritjen e kapacitetit prodhues të Pasaportave deri në 6.000 (gjashtëmijë) njësi për Ditë Pune;
2. pajisjen me Dokumentet e Refugjatëve;
3. hapjen e Zyrave të Aplikimit në Ambasada;
4. ofrimin e Shërbimeve të Dokumentit me Procedurë të Shpejtë.

Shërbimi i Dokumentit me Procedurë të Shpejtë - nënkupton lëshimin dhe shpërndarjen e Pasaportave Aplikantëve brenda një periudhe kohore prej jo më shumë se 3 Ditë Pune nga data e aplikimit të rregullt dhe marrjes me sukses së të dhënave të Aplikantëve pranë Zyrave të Aplikimit, në përputhje me specifikimet e parashikuara në Programin 20 (Specifikimet Teknike për Dokumentin me Procedurë të Shpejtë).

Zyrat e Aplikimit në Ambasada - nënkupton Zyrat e reja të Aplikimit që do të hapen nga Shoqëria Konçesionere pranë zyrave konsullore/ambasadave të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve dhe specifikimeve të Programit 19 (Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada).

Dokumente Identiteti për Refugjatët - nënkupton Kartën e Identitetit dhe Dokumentin e Udhëtimit për refugjatët të prodhuar dhe shpërndarë nga Konçesionari në përputhje me specifikimet e parashikuara në Programin 18 (Specifikimet Teknike për Dokumentet e Identitetit të Refugjatëve).

Rritja e Kapacitetit për Pasaportat - nënkupton dyfishimin e kapacitetit të personalizimit të Pasaportave, në përputhje me specifikimet e parashikuara në Programin 17 (Specifikimet Teknike për Rritjen e Kapacitetit të Pasaportave).

- 1.2 Në Programin 1 (Përkufizimet) të Marrëveshjes së Konçesionit përkufizimi i "Shërbimeve" ndryshohet si më poshtë:

Shërbime -nënkupton operimin e Konçesionit dhe çdonjë e të gjitha shërbimet që do të sigurohen nga Konçesionari bazuar në këtë Marrëveshje, duke përfshirë ato të përcaktuara në Programin 2 (Kërkesat e Autoritetit), Programin 3 (Zgjidhja e Konçesionarit), dhe Programet e reja të kësaj Marrëveshje:

- Programin 17 - Specifikimet Teknike për Rritjen e Kapacitetit të Pasaportave;
- Programin 18 - Specifikimet Teknike për Dokumentet e Identitetit të Refugjatëve;
- Programin 19 - Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada;
- Programin 20 - Specifikimet Teknike për Dokumentin me Procedurë të Shpejtë;
- Programin 21 - Çështjet e Reja Financiare.

- 1.3 Neni 1.7 i shtohet Marrëveshjes së Konçesionit si më poshtë vijon:

1.7 Palët bien dakord se në kontekstin dhe me qëllim zbatimin e plotë të Nenit 1.5, Programi 17 (Specifikimet Teknike për Rritjen e Kapacitetit të Pasaportave), Programi 18 (Specifikimet Teknike për Dokumentet e Identitetit të Refugjatëve), Programi 19 (Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada), Programi 20 (Specifikimet Teknike për Dokumentin me Procedurë të Shpejtë), do të konsiderohen si pjesë plotësuese e kërkesave të Autoritetit, në përputhje me Programin 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Programi 21 (Çështje të Reja Financiare) do të konsiderohet si pjesë plotësuese e Programit 11 (Çështje Financiare).

- 1.4 Në Nenin 3.1.3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.4.1 Në paragrafin (i) pas fjalëve "Programet 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe 3 (Zgjidhja e Konçesionarit)" shtohet dhe Programin 17 (Specifikimet Teknike për Rritjen e Kapacitetit të Pasaportave)

1.4.2 Paragrafi (ii) ndryshon si më poshtë:

- (ii) ngritja e një rrjeti Zyrash për Aplikime të siguruara me personel të kualifikuar, regjistrim të përshtatshëm dhe pajisjet për aplikime për Dokumente Identiteti sipas specifikimeve të Programit 2 (Kërkesat e Autoritetit), Programit 3 (Zgjidhja e Konçesionarit) dhe Programit 19 (Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada). Palët bien dakord se, në lidhje me Zyrat e Aplikimit në Ambasada, një pjesë e personelit të kualifikuar për ofrimin e Shërbimeve do të sigurohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë mbështetur në përshkrimin e punës dhe specifikimeve të Programit 19 (Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada), të trajnuar nga Shoqëria Konçesionare. Me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve, Konçesionari mund të hapë Zyra shtesë të Aplikimit në Ambasada në vende të tjera të huaja, sipas Programit 21 (Çështje të reja Financiare) të Marrëveshjes.

1.4.3 Shtohen paragrafët (v) dhe (vi) sipas përmbajtjes së mëposhtme:

- (v) projektimi, ngritja, zhvillimi, zbatimi dhe operimi i Sistemit për pajisjen me Dokumente Identiteti të Refugjatëve, në përputhje me specifikimet e Programit 18 (Specifikimet Teknike për Dokumentet e Identitetit të Refugjatëve);
- (vi) projektimi, ngritja, zhvillimi, zbatimi dhe operimi i Sistemit për ofrimin e Shërbimeve të Dokumentit me Procedurë të Shpejtë, në përputhje me specifikimet e Programit 20 (Specifikimet Teknike për Dokumentin me Procedurë të Shpejtë).

1.5 Nenet 17.3.3, 17.3.4, 17.3.5, 17.3.6 dhe 17.3.7 i shtohen Marrëveshjes së Konçesionit me përmbajtjen e mëposhtme:

17.3.3 Palët bien dakord se shuma totale prej 3.260.100 (tre milion dyqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind) Euro, siç specifikohet në Programin 21 (Çështje të Reja Financiare - Seksioni Përmbledhës), do të paguhet nga Autoriteti si vijon:

- (i) Një shumë prej 191,662,860 Lekësh (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) do të konsiderohet si pagesë e menjëhershme e kryer nëpërmjet kompensimit me Tarifën e Konçesionit për vitin 2009;
- (ii) Shuma e mbetur do të kompensohet nga Tarifa e Konçesionit për vitin 2010. Shoqëria Konçesionare do të njoftojë Autoritetin, brenda afatit të përcaktuar në Nenin 17.2 të Marrëveshjes, për kryerjen e kompensimit të parashikuar në këtë paragraf;

- (iii) Palët bien dakord se në rast se Tarifa e Konçesionit për vitin 2010 nuk do të jetë e mjaftueshme për të mbuluar këtë shumë, Autoriteti do t'i paguajë shumën e mbetur Konçesionarit brenda 1 (një) muaji nga mbarimi i afatit për pagesën e Tarifës së Konçesionit për vitin 2010 nga Konçesionari, siç specifikohet në Nenin 17.2 të Marrëveshjes.
- (iv) Për pagesat që janë kryer apo që do të kryhen sipas parashikimeve të mësipërme, kursi i këmbimit valutor ndërmjet Lekut dhe Euros do të konsiderohet kursi i këmbimit i publikuar nga Banaka e Shqipërisë në datën kur janë kryer pagesat.

17.3.4 Në përputhje me Programin 21 (Çështje të Reja Financiare), Palët bien dakord se Autoriteti do t'i paguajë Konçesionarit koston përkatëse për ofrimin e Shërbimeve në Zyrat e Aplikimit në Ambasada siç specifikohet më poshtë:

- (i) Në rast se Zyrat e Aplikimit në Ambasada nuk do të arrijnë një nivel minimal aplikimesh për Pasaporta prej 1000 njësisish për muaj (me një tolerancë prej 10%) për çdo Zyrë Aplikimi në Ambasada, për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh, siç specifikohet në Programin 19 (Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada), Autoriteti do t'i paguajë Konçesionarit kostot e pambuluara të instalimit (diferenca ndërmjet kostove të instalimit dhe kostove të mbuluara nga Shoqëria Konçesionare nëpërmjet shitjes së Dokumenteve të Identitetit në çdo Zyrë Aplikimi në Ambasada), siç specifikohet në Programin 21 (Çështje të Reja Financiare - Seksioni 3 - Kostot e instalimit).

17.3.5 Në rast se Autoriteti nuk mbulon shumat sipas Nenit 17.3.3 dhe 17.3.4, këto shuma do të kompensohen me Tarifën e Konçesionit.

17.3.6 Në rast se Shoqëria Konçesionare nuk do të arrijë nivelin minimal të aplikimeve për Pasaporta të parashikuar në Nenin 17.3.4, paragrafi (i), Konçesionari ka të drejtë të:

Të njoftojë me shkrim 1 (një) muaj përpara Autoritetin për mbylljen e mundshme të Zyrës së Aplikimit në Ambasada. Autoriteti mund t'i kërkojë Konçesionarit të vazhdojë ofrimin e Shërbimeve në Zyrat e Aplikimit në Ambasada dhe t'i paguajë Konçesionarit kostot e parashikuara në Nenin 17.3.4, paragrafi (ii). Nëse Autoriteti nuk do t'i japë një përgjigje me shkrim Konçesionarit brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të mësipërm, Shoqëria Konçesionare ka të drejtë të mbyllë Zyrat e Aplikimit në Ambasada. Në rast se Autoriteti do t'i kërkojë Shoqërisë Konçesionare të mbajë hapur Zyrat e Aplikimit në Ambasada, Autoriteti do të kompensojë Shoqërinë Konçesionare për kostot e korrente vijuese bazuar në modalitetet e parashikuara në Nenin 17.3.4.

17.3.7 Në lidhje me ofrimin e Shërbimeve në Zyrat e Aplikimit në Ambasada, Palët bien dakord se në rast vonesash në raportime dhe pagesa nga këto zyra

siç specifikohet në Programin 19 (Specifikimet Teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada), Shoqëria Konçesionere ka të drejtë të ndërpresë dorëzimin dhe shpërndarjen e Dokumenteve të Identitetit në Zyrat e Aplikimit në Ambasada.

1.6 Titulli i Nenit 17.5 ndryshohet si vijon: *"Çmimi për Njësi i Kartave të Identitetit dhe Pasaportave Elektronike/ Dokumenteve për Refugjatët/ Dokumenteve në Zyrat e Aplikimit në Ambasada/ Dokumentit me Procedurë të Shpejtë.*

1.7 Neni 17.5.1 i Marrëveshjes së Konçesionit ndryshohet si vijon:

17.5.1 Çmimi për Njësi i Dokumenteve të Identitetit/Dokumente për Refugjatët/Dokumente në Zyrat e Aplikimit në Ambasada/ Dokumentit me Procedurë të Shpejtë do të jetë çmimi i ofruar nga Konçesionari dhe i pranuar nga Autoriteti, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje si Programi 11 (Çështje Financiare) dhe Programi 21 (Çështje të Reja Financiare). Çmimi për Njësi do të jetë çmim neto (duke përjashtuar TVSH). Për më tepër, Çmimi për Njësi nuk përfshin taksat apo detyrimet për vula, nëse ka të tilla, të zbatueshme sipas ligjit shqiptar.

1.8 Nenet 18.3, 18.4, 18.5 dhe 18.6 i shtohen Marrëveshjes së Konçesionit me përmbajtjen vijuese:

18.3 Duke deroguar shprehimisht nenin 25.8, 37 dhe 38 të ligjit nr. 7928 datë 27 prill 1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", të ndryshuar, dhe paragrafin 13, 14 dhe 19 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 17, datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që nuk është në përputhje me këtë nen 18.3 të Marrëveshjes, Palët bien dakord se Konçesionarit do t'i kreditohet dhe rimbursohet plotësisht çdo dhe të gjithë shumat e TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve deri në datën 30 qershor 2010, shumë e cila nuk i është kredituar për shkak të zbatimit të parashikimeve të nenit 25.8 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar. Palët bien dakord se TVSH që nuk është kredituar për periudhën Janar 2009 deri në Qershor 2010 do të kreditohet në përputhje me parashikimin e këtij neni 18.3 të Marrëveshjes duke filluar nga muaji pas hyrjes në fuqi të këtij neni 18.3, nëpërmjet sistemimit të kreditimit të TVSH-së.

18.4 Për periudhën që fillon nga data 1 korrik 2010, Konçesionari do të ketë të drejtë të kreditojë çdo dhe të gjithë shumat e TVSH që kanë të bëjnë me blerjen e mallrave dhe shërbimeve, duke deroguar shprehimisht nenin 25.8 dhe 33 të ligjit nr. 7928, datë 27 prill 1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", të ndryshuar, dhe paragrafin 19 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 17, datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar, dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që nuk është në përputhje me këtë nen të Marrëveshjes. Të gjitha shumat e TVSH të akumuluar në blerje që nuk është kredituar do të kreditohet nga Shoqëria Konçesionere në deklaratën vijuese të TVSH pas Datës Efektive të këtij Ndryshimi në Marrëveshjen e Konçesionit.

Për qartësi, Palët pranojnë dhe njohin se TVSH e pakredituar gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Konçesionit, është njohur si shpenzim i Shoqërisë Konçesionere për qëllime tatimore dhe pagesa e TVSH të pakredituar sipas kësaj Marrëveshje do të konsiderohet, për qëllime tatimore, si e ardhur e vitit 2010.

18.5 Palët pranojnë se çmimi/kostoja e ofruar nga Konçesionari për makinerinë për dyfishimin e kapacitetit të prodhimit të Pasaportave në 6.000 njësi në ditë, është një çmim neto dhe nuk përfshin tatimin në burim që Konçesionari mund të jetë i detyruar të paguajë për këtë qira. Në rast se Konçesionarit do t'i duhet të zbatojë këtë tatim, atëherë kosto e makinerisë që do të paguhet nga Autoriteti do të rritet me shumën e këtij detyrimi.

18.6 Palët bien dakord se faturat që do të lëshohen nga Konçesionari për pagesat sipas Nenit 17.3.3 dhe 17.3.4 të kësaj Marrëveshje do të jenë pa TVSH.

1.9 Neni 38.8 i shtohet Marrëveshjes së Konçesionit me përmbajtjen vijuese:

38.8 Autoriteti do të bashkëpunojë me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe çdo Ent Shtetëror në mënyrë që të koordinojë, sigurojë dhe garantojë hapjen, operimin dhe funksionimin e Zyrave të Aplikimit në Ambasada, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshje. Për këtë qëllim Autoriteti do të ndihmojë në lidhjen e një memorandumi mirëkuptimi ndërmjet Shoqërisë Konçesionere, Autoritetit, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Financave për standartizimin, rregullimin dhe minotorimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre palëve në lidhje me hapjen dhe funksionimin e Zyrave të Aplikimit në Ambasada.

Neni 2 - Hyrja në fuqi dhe Data Efektive

- 2.1 Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të saj me ligj nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë. Për këtë qëllim, Data Efektive do të konsiderohet data e hyrjes në fuqi të ligjit të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë që miraton këtë Kontratë.
- 2.2 Në rast se Data Efektive nuk ndodh prenda një periudhe prej 90 (nëntëdhjetë) Ditë Pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët, secila Palë ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë duke i dhënë një Njoftim për Përfundim Palës tjetër të paktën 5 (pesë) Ditë Pune përpara. Pas marrjes së këtij Njoftimi për Përfundim, Palët e kësaj Kontrate nuk do të kenë të drejta apo detyrime të tjera sipas kësaj Kontrate përveç të drejtave dhe detyrimeve që shprehimisht njihen dhe respektohen edhe pas zgjidhjes së kësaj Kontrate.

Neni 3 - Të ndryshme

Republika e Shqipërisë
Ministria e Brendshme

Grupimi Morpho dhe Fondi Shqiptaro - Amerikan i Ndërmarrjeve
Përfaqësuar nga Aleat sh.p.k

3.1 Për çdo çështje tjetër që nuk rregullohet nga kjo Kontratë do të zbatohen parashikimet respektive të Marrëveshjes së Konçesionit.

Për sa më lart, Palët dhe përfaqësuesit përkatës të tyre e pranojnë dhe e nënshkruajnë këtë Kontratë.

Për Ministrinë e Brendshme
të Republikës së Shqipërisë

Z. Lulzim Basha,
Ministër

Konçisionari

Përfaqësuar në këtë Kontratë nga

ALEAT Shpk
Përfaqësuar nga Z. Jean - Alain Jouan
Drejtori i Përgjithshëm